

## Arlind FARIZI

### LETËRSIA DHE TELEFONI

UDC 821.18.09

**Abstrakt:** Studimi në fjalë merr në analizë librin “Hajdegeri, Habermasi dhe Telefoni Mobil” të autorit George Myerson i cili për studim të thelluar dhe shumë aktual ka teknologjizimin në rritje në shekullin 21 dhe shikimin e këtij procesi nga perspektiva filozofike. Përqasja jonë do jetë pikërisht kjo ndërlidhje, ky raport por me letërsinë, lexuesin, shijen letrare dhe sfidën e librit e botuar. Në mënyrë të veçantë Myerson tregon një përballje të frikshme mes kulturës së re në rritje të mobilit, apo, siç e quan ai, “kulturës së telefonizimit” në njërën anë jep dhe pikëpamje filozofike mbi komunikimin. Edhe letërsia është komunikim. Se si kjo reflektohet në letërsinë, mbi lexuesin, a ka ardhur koha për: e-book të letërsisë, e-lexues të letërsisë, për e-kritikën e letërsisë.

Hyrje

Duhet thënë që në fillim të studimit se përcaktimi i epokës së telefonizimit është që të na dërgoj përtej “botës së dialogut” në një botë tjetër, ku komunikimi nënkupton diçka më të pasur dhe gjithashtu shumë më të shpejt. Meyrsoni mendon që telefoni është duke e zhvendosur mënyrën e vjetër të komunikimit fytyrë – më - fytyrë, në diçka tjetër që është më virtuale, duke qenë se komunikimi sot kryhet kryesisht përmes teknologjisë.

Në rastin tonë letërsia dhe kultura e re tashmë e krijuar dhe etabluar si e telefonizimit, ka një marrëdhënie të çuditshme dhe shqetësuese për kandarin e vetëm të saj, vlerën estetike. Kjo marrëdhënie shkoi përtej pritshmërive tona, përtej naivitetit tonë prej lexuesi libri prej letre, përtej dëshirës për vizituar bibliotekat, përtej botimit dhe gjetjes së mjeteve për botim dhe kaloi në një dimension tjetër, në një lexues bardhësisë ekranesh, në një lexues shkrimesh as sa nxë telefoni, në një lexues portalesh shpesh të paverifikuar dhe të regjistruar ligjërisht, në lexues shkrimesh nga profile faacebook, instragrami, tuiteri, etj. A jeni të përgatitur shpirtërisht dhe kulturalisht për këtë *fastfood letërsi* që na servohet çdo ditë?! A jeni ne të njëjtit e para dhjetë viteve në raport me librin, sa ka ndryshuar qasja jonë ndaj librit të shtypur, poezisë, romanit, studimeve shkencore.

Bota e cila rregullon proceset e prodhimit kulturor – të njohura si “industritë kulturore” është duke e ngushtuar respektin që kishin dikur proceset e përqendrimi tregtar dhe industrializimin e kulturës. Krijimi, në fakt letërsia është gjithmonë më pak spontane dhe gjithmonë e më shumë diçka e planifikuar dhe e projektuar si produkt kulturor. Në këtë këndvështrim, e rëndësishme është qarkullimi tekstual pavarësisht letrës apo ekranit. Sistemet e magazinizimit, të paketimit të produktit letrar, nuk janë të parëndësishme, por ja që po bëhen relative në kohën e telefonizimit.

Parësor është teksti i mirëfilltë letrar. Prandaj, këmbëngulja jonë që nga fillimi se libri shtypur është medoemos letërsi dhe libri në ekran është jo letërsi është për t’u studiuar. Letërsinë e formojnë tekstet e mirëfillta, janë po ato tekste që rrojnë në mënyrë të veçanta brenda kulturave të veçanta duke kaluar nga brezi në brez, sepse vlera estetike e stilistike e tyre u ka mbijetuar procesit të filtrimit që i bën Historia vetë librit.

Letërsia në kohën e telefonizimit, ka armiqtë e saj që falas dëmtojnë vlerën e saj. *Interneti ka një mënyrë specifike në raportin me botën e Letrave* thotë Joaquin Romero në eseun e tij *Letërsia dhe Interneti* të botuar në revistën *Ars*, nr 14. 2014. Ai thotë se në fillim ekzistonte një mosbesim dhe dukej sikur libri dhe kompjuteri përfaqësonin hapësira të ndara, të papajtuashme, antagoniste. Të dy ishin standarde

të dy botëve, i traditës kulturore dhe revolucionit teknologjik. Këtë dilemë ai e sqaron:se Libri nuk është letërsia, as kompjuteri nuk është vegël e thjeshtë teknologjike. Libri nuk është më shumë se një medium material i fjalës, një formë historike e paketimit të fjalëve për ti bërë ato që të arrijnë tek të tjerët dhe për të dialoguar. Identifikimi mes letërsisë dhe librave është një operacion retorik në të cilin merret ena në vend të përmbajtjes. Librat nuk janë letërsia. Pikë. Librat janë shkatërruar, por njerëzit i ruajnë në kujtesë. Vdesin objektet, materialja, por informacioni shtresohet në mendje dhe vazhdon të qarkullojë në formë klandestine. Sa mendime të poetëve klandestinë, të ekskomunikuar e të censuruar janë fshehur jo në libra por në mendjet e njerëzve për t'u ikur ndjekjeve, të autorit dhe të lexuesit. A nuk u lexua tinëz romani *Gjarpërinjtë e gjakut* të Ademi Demacit, revista *Alternativa...* në kohë të sërta politike?! Duhet thënë se Letërsia e mirëfilltë është përpara librave dhe pas vdekjes së librit. Libri është zgjidhje historike – një zgjidhje e mirë, si shembull mi mirë se di duhet ruhet dhe përhapet fjala. Cilët janë armiqtë falas të librit të letërsisë? Sot ka aq aparate teknologjike, telefon, smartfone, ipad dhe kompjuterë, si qëndron raportin me lexuesin, studiuesin, për llojet e kërshërive lexuese.

Llojet e lexuesve sipas Herman Hesesë:

#### *Lexuesi që e përjeton librin thjesht si përmbajtje*

Me raste, të gjithë lexojmë në mënyrë naive. Ky lloj lexuesi e konsumon librin ashtu siç konsumon ushqimin: ai ha dhe pi deri në ngopje. E njëjta gjë me librin. Ky lloj lexuesi, qoftë një fëmijë që lexon përralla me indianë, adoleshente që lexon novela romantike apo studentë filozofie, thjesht merr informacion. Ky lloj lexuesi është i lidhur me librin si kafsha me të zotin: libri drejton, lexuesi ndjek. Thelbi i librit pranohet objektivisht, me realizëm. Megjithatë, edhe në këtë grup ka lexues të rafinuar, sidomos sa i përket letërsisë artistike.

#### *Lexuesi me imagjinatë?*

“Ai që zgjedh të ndjekë instinktin në vend të edukimit bëhet edhe një herë fëmijë dhe rrjedhimisht gjithçka që e rrethon merr formë tjetër: buka bëhet mal, i përshkuar tejprtej nga tunele të thellë; shtrati bëhet... shpellë, kopsht, fushëbetejë... gjithçka që e lejon imagjinata. Ky është thelbi i tipit të lexuesit imagjinues. Ai është në gjendje të ndërtojë historinë e tij ose të shtjellojë më tej atë që lexon. Për këtë lexues, as forma dhe as përmbajtja nuk janë aq të rëndësishme. Ai e di, ashtu si çdo fëmijë, se çdo objekt mund të ketë 10, 100... kuptime për mendjen.

Në ndryshim nga lexuesi që përjeton thjesht përmbajtjen, lexuesi imagjinar e ndjek librin jo si kafsha të zotin, por si gjuetari prenë”.

#### *Ëndërrimtari*

Tipi i tretë dhe i fundit i lexuesit është, me gjasë, e kundërta e atij që rëndon e quajmë lexues i mirë. Ai është tërësisht i pavarur dhe i lirë në mënyrën se si e përjeton procesin e leximit. Sipas këtij lloj lexuesi, qëllimi i leximit nuk është as edukimi, as argëtimi. Ai e përdor librin si çdo objekt tjetër, për të thelbi në fakt është stimuli që mund t'i japë (ose jo) çdo histori. Ai nuk ka nevojë për një filozof nga i cili të mësojë apo që ta kritikojë; ai nuk ka nevojë për një poet që t'i interpretojë jetën; kaq gjë e bën vetë. Nëse këtë lexues e tërheq një fjali e bukur në një libër, një sentencë, këshillë, gjëja e parë që bën është ta zbërthejë atë totalisht. Ky lexues e di fare mirë se për çdo të vërtetë qëndron plotësisht edhe e kundërta e saj.

Ky lloj lexuesi është i aftë të lexojë ç'të dojë por më e rëndësishmja, si të dojë. Në kulmin e kreativitetit ai mund ta lexojë "Kësulëkuqen" si një përrallë, por edhe si filozofi apo poemë erotike.

### **Sfida e librit**

A e mund telefonizimi një libër të mirë që të jetë më pak i dukshëm nga fakti se nuk hidhet ne etër?! Konvertimi në rritje i të gjitha instancave sociale dhe kulturore në një treg të thjeshtë bën që teksti i mirë të ketë këto sfida:

Të jetë i botuar kur ka mundësi dhe i tillë të hidhet në eter.

Nëse është i botuar, të merren nga ndonjë industri menaxhimi libri në eter dhe të shpërndahet e shitet, rasti Amazon.com, ... shtu dilemën se kush e filtron listën e librave që hidhen për shitje në Amazon, asnjë filtër, kush hap një akount, e hedh librin dhe vendos një çmim. Rastin i bestsellerëve shqiptar: Blushi, Fevziu, Rexhaj, të cilët përdorin menaxhimin e librit, e shitën librin, bënë dhe para por nuk e rritën assesi vlerën estetike që mund të ketë libri... Në disa raste mungon komplet shkrintari, ai është zëvendësuar me menaxherin shitës...

Nuk ka kënaqësinë e leximit të letrës, erën së librit, pasionit të ecjes së fletëve, shënimet anësh... S'ka art të të lexuarit...

Kultura e telefonizimit është e rëndësishme për librin për një kategori lexuesish, që duan në hapa të shpejta të lexojnë, ose bëjnë sikur lexojnë, të vjedhjes së lehtë, të recensioneve të lexuara për romane në vend të vetë romanit, të kritikës së *likeve* dhe filozofisë së bërjeqejeve nëpër facebook...

Fati i librit nuk është si fati i telefonit. Është koha e telefonit. Lexuesi sot ka një shtypshkronjë gjigante virtuale dhe një librari më përmasa dhome. Tekstet qarkullojnë në eter në formë të rrjedhshme, si lum.

A ka arritur lexuesi i sodit në nivelin e pjekurisë kulturore për tu çliruar nga materializimi objekt-libër. Apo e është dorëzuar para ekranit të telefonit kësaj magazinë të pamatë ku gjende miliona faqe virtuale? Lexuesi i sodit ka kokë dhimbje. Është rob digjital. Adhures *tachshkrini*. Zvirgjeronë çdosekondshëm ekrane telefonash me idenë e marrjes informacionit. Letërsia më pak i intereson së kronika e zezë, poezia më pak i del përpara se sa foto nudo të ndonjë eskorte, flaerë politikanësh që gjetën formën më të mirë të shumëfishimit të rrenave përmes ekranit... Letërsia mbetet skajore ose vetëm për blogerët e letërsisë, për lexuesit e pasionuar, për postuesit e ndonjë vargu ose poezie, thjesht për qejf.

*Shembuj:*

**Në rastin e poezisë**, duke qenë së është më e shkurtër dhe më koncize nuk shoh ndonjë ndryshim në raport më kënaqësinë e tekstit të lexuar në letër apo në ekran, pdf, ose një shpërndarje eterit, facebook, insgram. Madje e shoh ekranin si një mundësi e mirë e shpërndarjes, krijimit të lexueshmërisë më të madhe në të gjithë llojet e lexuesve.

**Në rastin e prozës - romanit**, duke qenë së është vepër kompozicionale, nuk e shoh si ka lexues të cilën do kënaqën së lexuari dhe përjetuari tekstin nëse të njëjtën e lexojnë në një ekran ipadi. Romani do vëmendje më të madhe, do një cep dhome ku mund të ulësh dhe të ndash dy tri orë, arti i leximi të romanit është dhe arti shkrintit, teksa lexohen romani, merren dhe shënime, pika orientuese për rilexime që do pasojnë, ka thyerja faqesh, shkarravitje të qëllimshme me idenë e kopjimit, shënime të shkurtra për personazhe të caktuara... Romani kërkon strategji leximi të cilën nuk e bën dot më një ekran, ku po i njëjtë roman është në formën elektronike. Mbase dhe drita e pengon dhe largon koncentrimin e duhur. Drita të lodh më shumë se letra. Lodhja të heq kënaqësinë e leximit. Në fund del një lexim i improvizuar.

**Në rastin e librit shkencor**, studimit, kritikës letrare mund të themi se po krijohet një *copy past* shkence e madhe e letërsisë. Vjedhje të gjithanshme, të secilit prej secilit, pak *make up* shkencor dhe ja një studim. Tradita e shkencës së letërsisë mbështetur në libra të botuar, të kaluar nëpër filtra të redaksive serioze, të shikuar nga lektorë profesionist dhe redaktorë përgjegjës dhe të kujdesshëm për librin e botuar, disajnerë që të ftojnë që në kopertinë libri për lexim, janë treguesit e një punë titanike dhe më përgjegjësi që ka libri shkencor. Shpërndarja e punimeve shkencore eterit, doktoraturat *online*, magistraturat *online*, dhanë mundësinë e vjedhjes së rehatshme të shkencëtarit të cilit i ngutet të bëj punimin e tij aspak origjinal. Punimi ngjanë një pazëlli ku me pakës kontroll serioz gjen vjedhjet që ia lejojnë pikërisht version elektronik i librit shkencor. Po aq sa është e shpejtë mundësia e vjedhjes aq e lehtë është dhe gjetja. Në këtë rast komisionet e temave të doktoraturave dhe magistraturave, kanë barrën më të madhe, të hetimit, gjetjes dhe dënimit të plagjiaturave që vijnë pikërisht në saj të librit elektronik që shëtit eterit. Mund të them se para kohës së internetit shkencën e letërsisë, mendimi kritik ishte shumë serioz dhe i njëjti ka aktualitetin e duhur edhe s

Është sot, merren për bazë, Miroslav Bekeri, Darko Grlic, Ibrahim Rugova, Qosja, Aliu e Vinca, Sinani, Çiraku,... referencave të palëvizshme shkencore të cilave u kthehet një shkencë e tërë. Tradita e botimit të librit shkencor para kohës së internetit ka qenë e pastër, kur kemi parasysh emra të etabluar të shkencës, ndoshta ka pasur ideologji por jo vjedhje majtash djathtas dhe shumëfishim të kopjeve.

Kultura e telefonizimit është një mjet komunikimi horizontal. E ky horizontalitet rrjedh nga konfiguracioni i tij si rrjet. Kjo kulturë që na përpiu çdogjenë e mundshme madje dhe intimitetin, nuk ka strukturim hierarkik, i cili duhet të ndajë prodhuesit dhe marrësit, të gjithë prodhojnë të gjithë marrin, kjo kulturë vetëm teoritikisht mund të strehojë vizitorë pa shije. Rregullat e prodhimit janë të çorientuara. Ku nuk vlen ende sa duhet *copyrighti*. Nuk dimë cilin ta quajmë autor dhe çfarë duhet të bëjë ai për të qenë i klasifikuar si tillë. Rregullat e prodhimit material, që mund të quhen botues dhe cilat janë kushtet ligjore, ekonomike, të shitjes, menaxhimit... Rregullat e shpërndarjes nuk prekin kushtet fizike, ligjore, ekonomike, treg i lirë, I vlerës dhe antivlerës. Konsumi edhe i letërsisë ka do kushte të veta. Zakonet e leximit, shijet, klasifikimi që duhet të rregullojë universin tekstual dhe për ta vendosur në raftet të caktuar virtual të librit serioz.

Të publikosh në internet do të thotë të bësh publike një shkrim, një poezi, një roman, një studim... Qarkullimi i një seri tekstesh të ngjashme mund më një lehtësi të madhe të pranohen nga një komunitet i madh, ku ta dimë se sa është lexuesi virtual... Për dallim nga libri, në procesin që nga shkrimi deri në publikim janë krijuar një mori e tërë institucionesh ndërmjetësi të cilat janë të specializuara në funksion të botimit të publikimit të librit. Rezultatet tregojnë së evolucionit historik i librit të botuar në raport më publikuesit në eter, libri i shtyp realizon më shumë funksione si procesi krijues, tipografia, lektura, redaktuara, dizajni...

Për me tepër, Meyrsoni mendon që telefoni mobil në shekullin 21, është shndërruar edhe në mënyrë jetese:

*“Telefoni është objekt dhe pajisje teknologjike. Por gjithashtu është pjesë e sistemit tonë të ideve, madje edhe mënyrë e jetesës së përditshme. Telefoni është bërë pjesë e një ideje të familjes, intimitetit, urgjencës dhe punës. Mesazhi i telefonizimit ka të bëjë me atë se telefoni i vjetër ka marrë fund, kështu që me këtë ka marrë fund edhe sistemi i vjetër i ideve”.*

Duke e interpretuar Habermasin Meyrsoni thotë :

*“Ju nuk keni për qëllim që t’i përmbushni nevojat përmes komunikimit; ju synoni t’i zbuloni ato, t’i bëni të njohura”. Të tjerët pastaj mund të kundërpërgjigjen; mund të vendosin, veprojnë, ndihmojnë apo t’iu pengojnë.*

*Të komunikosh nënkupton t'i bësh dëshirat tua të kuptueshme dhe kurrsesi përmbushjen e tyre të menjëhershme. Gjithsesi ne shpesh përdorim fjalë për përmbushjen e ndonjë nevoje, por për Habermasin ky nuk është komunikim i vërtetë. Ne komunikojmë vetëm kur jemi të shqetësuar lidhur me atë që ta bëjmë veten tonë të kuptueshëm prej tjerëve”.*

### **Libri vs interneti**

Albert Ajnshtajni ka thënë: “Druhem se do vijë dita kur teknologjia do të tejkalojë ndërveprimin tonë njerëzor. Bota do ketë një gjeneratë idiotësh”. Vlen të përmendim Ted Nelson që ka nënvizuar: “Sipas kësaj perspektive, teksti elektronik shpejt do të zëvendësojë letrën dhe në një kohë të shkurtër, ne të gjithë do të jemi duke lexuar në ekrane”. Librat përbëjnë kapital. Një bibliotekë është jetëgjatë sa edhe një shtëpi, pra me qindra vjet. Në fund të fundit librat nuk janë mall konsumi por janë kapital. Dhe në rastin e profesionistëve, ata janë i vetmi kapital” – kështu do të thoshte Thomas Jefferson.

Keith Oatley, profesor i psikologjisë konjunktive në Universitetin e Torontos (dhe autor romanesh) ka hedhur hipoteza se leximi sjell një stimulim të gjallë të realitetit. “Ngjarja projektohet në mendjen e lexuesit njësoj siç projektohet një simulim kompjuterik në monitor” Bota e sotme po ecën me galop, por së bashku me zhvillimin teknologjik po shtohen edhe problemet që u vijnë njerëzve nga përdorimi i shumtë i celularëve dhe internetit. Probleme shëndetësore, por edhe sjellje antishoqërore, këto janë disa nga pasojat negative të teknologjisë Disa studime të fundit e kanë lidhur celularin me probleme të jetës së përditshme si shpërqendrimi, rreziku shëndetësor dhe probleme me gjumin. Por a është vërtetë kaq i dëmshëm për shoqërinë dhe shëndetin celulari? Një nga studimet e publikuara këtë javë ka zbuluar se nëse nuk kemi celularin me vete ose pranë, kjo na bën më pak të përqendruar, rrit presionin e gjakut dhe na bën të ndihemi pa qejf. Varësia nga celularët është bërë një problem madhor, aq sa të qenët larg tyre na kufizon funksionet tona konjiktive dhe na bën të ndihemi jo mirë fizikisht, sipas shkencëtarëve. Ky ishte një ndër studimet e para që konstatoi se çfarë i ndodh njerëzve që janë të ndarë nga celularët dhe zbulimet nuk ishin aspak të favorshme për ne. Sipas përfundimeve, ne kemi performancë të ulët në detyrat mendore pa mjetin teknologjik që e kanë shumica e njerëzve në planet. Për më tepër, ndarja nga celulari na rrit të rrahurat e zemrës dhe nivelet e presionit të gjakut, duke na çuar në ankth dhe ndjenjë pakënaqësie.

Në eksperimentet e studiuesve të Universitetit të Mizurit për studimet e gazetarisë, u zbulua se personave që iu mor celulari nga kërkuesit përpara se të zgjidhnin një lojë me plotësimin e fjalëve, dolën më keq sesa ata që kishin celularët me vete’. “Hulumtimi ynë zbuloi se ndarja e përdoruesve të celularëve nga teknologjia e tyre e komunikimit, ka pasojë negative”, tha Russell Clayton, një kandidat doktore në Universitetin e Mizurit. Kaq e madhe është lidhja e njeriut me celularin, sa që ai e mendon atë si një shtesë të vetes, pa të cilin ndihet në gjendje jo të mirë shëndetësore. Sipas kërkuesve, përdoruesit e celularëve duhet ta shmangin ndarjen nga teknologjia në situata të përditshme që kërkojnë vëmendjen e tyre të plotë, pasi rrezikojnë të performojnë më dobët se zakonisht. Kjo nuk lidhet me përdorimin e celularit në situata të tilla, por në disponimin e tij. Kërkuesit zbuluan se gjatë eksperimentit, kur pjesëmarrësit e studimit nuk mundën t’u përgjigjeshin telefonatave që u vinin, ritmi i zemrës së tyre u rrit dhe presioni i gjakut gjithashtu. Pjesëmarrësit nuk kishin dijeni se eksperimenti po zhvillohej mbi varësinë nga celulari, ata mendonin se ai kishte të bënte me presionin e gjakut dhe matjen nëpërmjet valëve të rrjetit.

Teknologjia po na bën antishoqërore Një studim i ndarë i kryer nga disa psikologë ka zbuluar se teknologjia e sotme kthen një nga dhjetë përdoruesit e vet në antishoqëror dhe narcizist. Në të gjithë

botën, kërkuesit kanë zbuluar se rreth 182 milionë prej nesh janë të varur nga përdorimi i internetit. Teksa uebi bëhet gjithnjë e më i përhapur, është shfaqur nevoja për studime serioze mjekësore në lidhje me çrregullimet që vijnë prej internetit. Psikologu Tomas Chamorro-Premuzic nga Universiteti Kolegj i Londrës dhe një skuadër psikologësh analizuan zakonet e celularëve dhe internetit të 1000 personave. Sëmundja më e re është quajtur “NetBrain” dhe ata që vuajnë prej saj tregojnë nivele në rritje të narcizmit, vëmendjes së pakët dhe frika se nuk po kënaqen sa të tjerët. Personat që vuajnë nga simptomat e mësipërme janë ata që kanë më shumë gjasa të luajnë kumar online dhe të përdorin rrjetet sociale dhe faqet e lojërave, si dhe aplikacionet. Për më tepër, personat që përdorin celularët e modelit të fundit me prekje, kanë tre herë më shumë gjasa të vuajnë nga ‘NetBrain’ sesa ata që kanë celularë të modeleve të vjetra. Ata që vuanin prej këtij shqetësimi kanë më shumë gjasa të shprehin sjellje antisociale, si për shembull përdorimi i celularit kur janë në prani të miqve. Studimi ofron prova për mënyrën sesi shoqëria moderne po përfaqon zhvillimin e teknologjisë dhe problemet që vijnë prej kësaj.

Personat që kanë simptomat e ‘NetBrain’ kanë më tepër gjasa të kenë tensione në jetën familjare dhe në punë, transmeton GSH. Një studim më i hershëm në dhjetor tregoi se celularët modernë po bëhen aq të integruar në jetët moderne, sa që mund të jenë duke ndryshuar edhe formën e funksionet e trurit të njeriut. Sa më i lartë të jetë zhvillimi i një shteti apo kontinenti, aq më i lartë është edhe rreziku që të preket nga sëmundjet që lidhen me teknologjinë e fundit.

### **Përfundim**

Kjo është edhe arsyeja, për të cilën mendojmë se kjo kulturë që po shtrihet fuqishëm duhet të vendoset në raport me konceptimin filozofik të komunikativitetit që ka letërsia dhe vetëm libri. Shekulli i ri po e ndryshon me këtë teknologji në masë, mënyrën tonë të jetuarit dhe mënyrën sesi komunikojmë me të tjerët. Perspektiva filozofike mbi atë se pse komunikojmë mes veti dhe perspektiva e “kulturës së telefonizimit” kanë përgjigje vetëm duhet t’u kthehemi tek dy mendimtarët e shek.20, Heidegger dhe Habermas dhe të mundohemi ti gjejmë çelësat për të kuptuar shoqërinë moderne, manipulimin dhe rolin e e-njeriut?